



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:070890

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05868376

P.nr.81/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të akuzuarit Rr. S, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën. par. 3.1. të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë -Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.152/2024F të datës 29.03.2024, pas mbajtjes së seancën së shqyrtimit fillestar, më datë 26.06.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ardiana Veseli, të dëmtuarës L. A., përfaqësuesit të palës së dëmtuar av. B. A. dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë mori publikisht shpalli ndërsa me datë 27.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

RR. S., i biri i A., dhe nënës R., e gjinisë M., i lindur me ..., në P., me vendbanim në fshatin K.-P., ka të kryer fakultetin e edukimit, i martuar baba i dy fëmijëve, I pa punësuar, me gjendje të dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datë 17.01.2024, rreth orës 22:00, në fshatin K.-P., konkretisht në shtëpinë e tyre, për shkak të mosmarrëveshjeve me të dëmtuarën-bashkëshorten e tij L. A., i pandehuri, ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarës, me qëllim të shkakimit të lëndimeve trupore ndaj saj, në atë mënyrë ditën kritike kur e dëmtuara ka qenë duke i vë fëmijët në gjumë, pas një zhurme që kishte bërë djali i tyre R., i pandehuri është ngrit nga shtrati dhe ka tentuar ta godas djalin, mirëpo aty ka ndërhyrë e dëmtuara, atëherë i pandehuri e ka kap për krahu të njëjtën, e ka shtyrë dhe e dëmtuara është përplasur për djepin, si pasojë e këtyre veprimeve të dëmtuarës i ka shkakuar lëndime trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, në formë të gjak mbledhjes nen lëkurore në regjionin e dorës, -

-me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 185 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242,364, 365, 368, 369, 449 dhe 452 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. Të akuzuarin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën **300.00€ (treqind euro)**, të cilin i akuzuari është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, e në rast se nuk e paguan atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim, konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), si në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.152/2024F të datës 29.03.2024, kundër të akuzuarit Rr. S., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën. par. 3.1. të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 26.06.2024, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, e dëmtuara L. A., përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. B. A. dhe i pandehuri.

I pandehuri pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit deklaroi: Se e pranojë fajësinë, rasti ka ndodhur aty për aty dhe se ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, i kërkoj falje bashkëshortes sime dhe i premtoj gjykatës se më nuk do të përsëris veprime të tilla, ne jemi pajtuar dhe jetojmë bashkë, kemi dy fëmijë, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. B. A. deklaroi: pala e dëmtuar e pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri për shkak se konsiderojmë se është në harmoni me dispozitat ligjore përkatëse. Ne si palë e dëmtuar tërhiqemi nga ndjekja penale vetëm për faktin se e dëmtuara me të pandehurin janë bërë bashkë përsëri me qëllim të ruajtjes së institucionit të familjes, kujdesit dhe rritjes së fëmijëve, ashtu që vet zhvillimi i kësaj procedure konsiderojmë se do të ketë efekte të mjaftueshme që të mos ken probleme në të ardhmen, kërkojmë nga gjykata që për shkak të këtyre rrethanave të shqiptoi një dënim sa më të lehtë.

E dëmtuara L. A. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, nuk kërkoj kompensim dëmi nga bashkëshorti, jetojmë bashkë,

i kemi tejkaluar problemet, kemi dy fëmijë, unë punoj si arsimtare, e lus gjykatën që brenda mundësive të shqiptoi një dënim sa më të lehtë ngase vetëm me pagën time jetojmë.

Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar në shkresat e lëndës. Pasi pranimi i fajësisë ka është në përputhje me dispozitat ligjore dhe ka bazë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, i propozojmë gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, dhe pranimin e fajësisë ta marrë si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet të akzuarit, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akzuarit përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën. par. 3.1. të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i vie keq për rastin, premtan se më nuk do ta përsëris veprën, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit, të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së, dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.81/24 me dt.27.06.2024.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.